

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PERGJEGJESI TE KUFIZUARA
“SEVEN COFFEE HOUSE” SH.P.K.

Sot, më datë 27.01.2022, ortakët themelues:

Z. Orgest Bircaj, atesia Fatosh, shtetas shqiptar, lindur ne Vlore, më 15.05.1983 banues në adresën Vlorë, mbajtës i pashaportës me nr. BE2550690 dhe me numër personal I30515124P madhore dhe me zotesi te plete juridike per te vepruar.

Z. Bledi Shkëmbi, atesia Vlladimir, shtetas shqiptar, lindur ne Korcë, më 13.08.1979 banues në adresën Korcë, mbajtës i pashaportës me nr. BF7132353 dhe me numër personal H90813074C madhore dhe me zotesi te plete juridike per te vepruar.

bazuar në legjislacionin shqiptar ne pergjithesi, personat fizik te mesiperm, kane vendosur si me poshte.

Emertimi, Selia dhe afati i Shoqerise

Neni 1

Te themeloje shoqerine me pergjegjesi te kufizuara , per te zhvilluar veprimtari private. Shoqeria eshte person juridik Shqiptar, veprimtaria e te ciles rregullohet nga kjo kontrate, Statuti i saj dhe Legjislacioni ne fuqi.

Neni 2

Shoqeria do te emertohe “SEVEN COFFEE HOUSE” SH.P.K.

Neni 3

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rr.Kavajës, pasuria me nr. 6/653 me sipërfaqe trualli, regjistruar ne ZK.8220 vol 56, faqe 56, me regjin bashkepronesie te pandare, objekti me nr. 19/2, 19/1 i quajtur reparti i targimit/kovacane, me sipërfaqe ndertimore 321.22 m², përballë Concord Center, Tiranë.

Neni 4

Shoqeria do te zhvilloj aktivitetin e saj me afat te pakufizuar.

Shoqeria “SEVEN COFFEE HOUSE” SH.P.K gezon statusin e personit juridik shqiptar nga momenti i regjistrimit si e tille ne regjistrin e QKR-se.

Neni 5

Shoqeria “SEVEN COFFEE HOUSE” SH.P.K do te kete si objekt:

Objekti i Veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë: Bar, kafe, pasticeri, restoran, katering, import eksport produkte ushqimore, shërbim delivery, organizim eventesh.

Neni 6

Shoqeria ushtron aktivitetin e saj mbi baze dege ne qytete te tjera te vendit,te cilat do te hapen pasi te kete filluar aktiviteti i shoqerise.

Neni 7

Selia e shoqerise mund te transferohet.



Neni 8

Kur shoqeria pushon veprimtarine e saj, pasi shlyen te gjitha detyrimet qe ka, pjesen e mbetur te kapitalit dhe te te ardhurave i perfitojne ortaket e saj.

Ortaku themelues perballojn humbjet e shoqerise deri ne kufirin e vleres se tyre te derdhur ne formimin e kapitalit themeltar. Kapitali baze mund te ritet nga fitimi ne natyre, ose kredi ne leke ose valute qe merret ne Bankat e Shtetit Shqiptar.

Kapitali themeltar per vazhdimin e aktivitetit te shoqerise eshte ne shumen 100.000 leke, qe i takon ortakeve themelues ne masen 100% ku 2 kuota jane te barabarta me 50.000 leke secila.

Fitimet qe do te rezultohet pas miratimit te bilancit vjetor nga Asambleja e Ortakëve pas zbritjes së taksave do te ndahen si vijon:

- Fondi rezervë.
- Shperblimi qe i takon ortakeve themelues ne masen 100%

Neni 9

Shoqeria mund te hyje ne veprimitari te perbashketa me shoqeri te tjera shqiptare ose te huaja edhe kur ato nuk kane objekt aktiviteti ate te shoqerise.

Neni 10

Veprimitaria e shoqerise mund te ushtrohet duke krijuar filiale ose perfaqesi brenda dhe jashte vendit, konformitet me ligjin shqiptar ose te huaj.

Te drejtat dhe detyrat e Ortakëve:

Ortakët gezojn keto te drejta kryesore:

Neni 11

- Administrimin e veprimitarise ne perputhje me kontraten dhe statutin.
- Pjesmarrjen ne rezultatet e cdo forme dhe sasie te veprimitarise se shoqerise e parashikuar ne kontraten dhe statutin e saj.
- Paraqitjen e propozimeve dhe shqyrtimin e tyre nga Mbledhja e Pergjithshme e Asamblese dhe organet e tjera te shoqerise.
- Te heqje dore nga shoqeria, heqja dore nga shoqeria nuk i liron ortaket nga detyrimet financiare te marra me pare ndaj shoqerise.
- Te marri pjese ne organet e shoqerise qe jane ose mund te krijohen nepermjet perfaqesuesit te tije ose vete.
- Te emeroje dhe te shkarkojne perfaqesuesit e saj, punonjesit,ekspertin kontabel dhe likuidatoret.

Ortakët kanë këto detyrime kryesore:

- Të depozitojë kuotën e tij dhe kuotën suplementare në përputhje me kontratën dhe statutin.
- Te marri pjese ne administrimin e shoqerise nepermjet organeve te krijuara nga vete ata.
- Ti japi shoqerise te dhënat e domosdoshme per perpunimin e cdo objekti te vecante lidhur me veprimitarine e saj.
- Te kryeje detyrat per realizimin e objektivave dhe te funksioneve te shoqerise.
- Ka detyrimin nese heqin dore nga shoqeria ti njoftojne vendimin e tij asamblese 6 muaj perpara dhe duke ceduar te drejten e zgjedhjes sipas nenit .
- Ti japi shoqerise informatat e nevojshme qe kane te bejne me ecurine e veprimitarise se saj.
- Te kryeje sherbimet e nevojshme per arritjen e objektivave te shoqerise dhe realizimin e funksioneve te saj.

Administrimi

Organi vendimor i shoqerise eshte Asamblea e Pergjithshme.

Neni 12

ADMINISTRATORI

Veprimtaria operative e shoqerise drejtohet nga Administratori i saj i Pergjithshem. Në shoqërine "SEVEN COFFEE HOUSE" SH.P.K administrator i shoqerise do te jetë Z. Mario Nikollli, lindur më 22.05.1993, me nr pashaporte BB0940500 dhe nr personal J30522066U, i cili ne te njejtën kohe ka edhe funksionin e perfaqesimit te shoqerise me te tretet ne gjithe veprimtarine se tije. Me miratimin e ortakëve mund te emerohen administrator dhe perfaqesues te shoqerise "SEVEN COFFEE HOUSE" SH.P.K. Administratori emerohet per një kohezgjatje prej pese vjetesh financiare me perjashtim te rasteve te doreheqjes ose shkarkimit te parakohshem. Administratori ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet me interes te shoqerise dhe ne emer te saj nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin eveprimtarise se shoqerise me perjashtim te atyre kompetencave qe ligji nuk i njeh. Administratori eshte perjegjes ndaj shoqerise apo te treteve per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit apo per faj te tij gjate administrimit te shoqerise.

Neni 13

Mbyllja e Shoqerise:

Veprimtaria e shoqerise pushon me propozimin e bere nga ortaku kur gjate dy vjeteteve nuk rezulton rentabel si dhe te gjitha rastet qe parashikohen ne dokumentet e krijimit te shoqerise (kontrata). Shoqeria shperndahet ne forme riorganizimi ose likuidimi.

Neni 14

Kur shoqeria likuidohet:

Asambleja e ortakut emeron likuidatorin, dhe shoqeria i jep fund veprimtarise se saj ne castin e miratimit te ketij bilanci te likuidimit. Komisioni i Likujdimit perbehet nga një ose tre antare. Pasurite qe jane vene ne dispozicion te shoqerise me te drejte shfrytezimi, shiten ne vartesi te shkalles se konsumit te tyre. Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se shoqerise e te filialave te saj dhe fondet financiare ndahan ndermjet ortakeve ne perpjestim me kuotat e vena ,pasi te jene bere pagesat per kreditoret.

Neni 15

Kur pushon veprimtaria e nje filiali,per efekte te riorganizimit te tij, afatet e pushimit caktohen nga Asamblea e Pergjithshme e Ortakut.


Likuidimi i filialeve behet njelloj si per shoqerine.

Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se filialit te likujduar dhe fondet e tij financiare vihen ne dispozicion te shoqerise pasi tu jene bere pagesat likujdatoreve.

Dispozita te hollesishme mbi organizimin e kesaj shoqerie percaktohen ne statutin e saj.

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË

ORGEST BIRCAJ



BLEDI SHKEMBI

